



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**VENDIM**

**K.P.P. 580/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Kappaoil” sh.a., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt, *Loti II "Blerje bateri për automjete"*, me nr. REF-21332-05-09-2019, me fond limit për njësi 355,370.83 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontratave 22,543,765 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Alked Kopaci” p.f., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Alked Kopaci” p.f., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Kappaoil” sh.a.  
Adresa: Lagjia 14, Rr. “Bajram Tusha”, Durrës

Operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.  
Adresa: Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Rr. “Aulona”, Fier

- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, nr.3, Tiranë
- Subjekte të interesuara:** Operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f.  
Rruga e Kavajës, Pallati nr. 102, Shkalla nr. 1, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të ankimuesve.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.05.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt, *Loti II "Blerje bateri për automjete"*, me nr. REF-21332-05-09-2019, me fond limit për njësi 355,370.83 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të

kontratave 22,543,765 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 03.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 19.06.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Alstezo” sh.a.	217,700 lekë, Skualifikuar;
2. “Alked Kopaci” p.f.	218,600 lekë, Kualifikuar;
3. “Kappaoil” sh.a.	229,400 lekë, Skualifikuar;
4. “Kadiu” sh.a.	241,417 lekë, Skualifikuar;

II.4. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Kappaoil” sh.a. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcën 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë katalogë/ broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Të gjithë dokumentat e hedhura, si pjesë të ofertës dhe të emëtuara “HEAVY DUTTY SHQIP”, “Nato bateri shqip 2019”, “Passenger cars shqip 2019 marked” nuk janë të lëshura nga kompanitë prodhuese, të deklaruara ne tabelën e përgjithshme të ofertës teknike. Po ashtu, ky dokumentacion nuk është i përkthyer nga përkthyes zyrtarë dhe nuk është i vërtetuar me origjinalin nga noteri publik.”*

II.4.1. Në datën 24.06.2019, operatori ekonomik “Kappaoil” sh.a. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kundërshton kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Alked Kopaci” p.f. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

*“[...]Se pari Sa me siper gjykojme se ky argument eshte teresisht i pasakte dhe i pavertete, pasi kompania KAPPAOIL eshte distribuori zyrtar per Shqiperine i kompanise YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE TIC.A.S qe ndodhet ne Organize Sanayi Bolgesi Oguz Caddesi No: 2 Sincan/ANKARA, Turqi, e cila na ka paisur me katalogjet perkatese ne gjuhen shqipe dhe me autorizimin e prodhuesit per te marre pjese ne kete procedure tenderimi. Ne autorizimin e prodhuesit ju keni te gjitha kontaktet e prodhuesit dhe do te duhej qe se paku te merrnit informacion nga prodhuesi referuar dhe pikes 6 te seksionit 2.3 kapaciteti teknik “Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet ajo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij’ në të cilën thuhet shprehimisht se nese eshte e nevojshme autoriteti kontraktor mund te kerkoje verifikimin e dokumentave te paraqitura.*

*Konstatimi juaj se keto katalogje nuk jane leshuar nga prodhuesi, pa u bere asnje lloj verifikimi apo kerkese per informacion nga prodhuesi, eshte i habitshem, krejtesisht i pabazuar dhe tendencioz ne te njeten kohe, nderkohe qe eshte detyrimi i juaj ligjor per verifikimin e dokumentacionit dhe jo gjykimi apo konstatimi apriori. Ne keto kushte kerkojme nga ana juaj verifikimin sipas dispozitave*

ligjore te parashikuaranese kalatogjet e paraqitura ne kete procedure tenderim jane leshuar nga Kompania prodhuese apo jo.

Se dyti ne seksionin 2.3 kapaciteti teknik pika 7 eshte kerkuar :1. “Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë të gomave, ku të për shihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë broshura duhet te markohen (per lehtësi identifikimi) artikujt goma dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët broshurat duhet të shoqërohen me një listë të gomave sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr.	Emertimi i artikullit (gomës)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Part-Number i prodhuesit	Standarti i Cilësisë
-----	-------------------------------	--------	-------	------------------------------	----------------------	--------------------------	--------------------------	----------------------

Ku per baterite NATO eshte kerkuar :

Specifikime teknike Bateri NATO:

Lloji Baterisë	Tensioni nominal	Kapaciteti Rezervë	Kapaciteti C20	Temperatura e operimit	Shkarkimi aktual+25°C-40°C	Rezerva e përdorshme	Jeta ne raft	Cikli jetës	Jeta	Teknologjia	Pesha me elektrolit
100 NA	12 V	190 min	100 AH	-40°C-+60°C		30% DoD	3 muaj	235	24 muaj	Kalciumi Plumbi	29.5kg
110 NA	12 V	200 min	110 AH	-40°C-+60°C	330 A 420s në UF 6V 120S në UF 6V	30% DoD	3 muaj	235	24 muaj	Kalciumi Plumbi	32,5kg
125 NA	12 V	235 min	125 AH	-40°C-+60°C	375 A 420s në UF 6V 120S në UF 6V	30% DoD	3 muaj	235	24 muaj	Kalciumi Plumbi	34 kg

Dimensionet (me 6 të NATO-s)

Nga informacioni qe kemi, ne kemi dyshime te arsyeshme se subjekti ALKET KOPACE nuk i ka plotesuar te gjitha specifikimet e kerkuara ne DST sa me siper lidhur me baterite NATO. Ju rikujtojme se vitin e kaluar, nga ana juaj bazuar dhe ne vendimin e KPP nr. Nr. 821/2018 dt 05.12.2018, per kete tender me te njejtin objekt dhe te njejten suate subjekti KAPPAIL eshte skualifikuar per mosplotesim te te gjithë zerave te kerkuara per baterite NATO. Ne te tilla kushte kerkojme nga ana juaj te vleresoni nese subjekti ALKET KOPACE i ka permbushur te gjitha

*specifikimet e kerkuara ne DST per baterite NATO duke perdorur te njejtin standart vleresimi ne vijimesi dhe per te gjitha subjektet njelloj. Ne rast te kundert kjo gje perben veper penale bazuar ne nenin 258 te KP "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" per te cilat ne jemi te detyruar te ndj ekim hapat e tj ere ligj ore .[...]"*

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1127/1 Prot. datë 01.07.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Kappaoil" sh.a., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

*"[...] Ofertuesi "KAPPA OIL" SHA ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentin e emërtuar "Autorizim", të lëshuar nga kompania prodhuese "Yigit Aku Malz.Nak.San.Ve Tic.A.S". Turqi, të përkthyer e noterizuar në gjuhën shqipe, me anë të të cilit autorizon shoqërinë "KAPPA-OIL." SHA të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje bateri për automjete" me produktet e tyre. Gjithashtu, ofertuesi ka paraqitur edhe dokumentin "Ofertë Teknike", në tabelën e të cilës ka deklaruar si kompani prodhuese të baterive që ofron, kompaninë "Yigit Aku Malz.Nak.San.Ve Tic.A.S". Turqi, duke përcaktuar në tabelë edhe emërtimin dhe numrin e faqes së katalogut për llojet e baterive të ofruara. Nga ana tjetër, ofertuesi "KAPPA OIL" SHA ka paraqitur si pjesë të ofertës së tij, në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentet me emërtim: "HEAVY DUTTY SHQIP-marked"; "Nato bateri shqip , 2019-market" "Passener cars shqip 2019 marked" për të cilat ka deklaruar dhe pretendon se janë katalogë/broshura të lëshuara nga kompania prodhuese "Yigit Aku Malz.Nak.San.Ve Tic.A.S". Turqi.*

*Nga verifikimi i këtyre dokumenteve, si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja, nuk rezultojnë të jenë: katalogë/broshura të lëshuara nga ky prodhues i huaj (turk), sepse dokumentat e paraqitura nuk origjinale në gjuhë të huaj, të përkthyer e të noterizuara në gjuhën shqipe nga një noter publik, duke mos arritur të provojë vërtetësinë e të dhënave në përmbajtje te dokumentit si dhe përputhshmerine e tyre me specifikimet teknike të kërkuara. Dokumentat e paraqitura të deklaruara dhe pretenduara: si katalogë/broshura, janë në gjuhën shqipe dhe nuk kanë asnjë referencë të prodhuesit të baterive "Yigit Aku Malz.Nak.San.Ve Tic.A.S", Turqi. të deklaruar nga ofertuesi. Si rrjedhojë, dokumentat e paraqitur nuk rezultojnë të jenë në përputhje me kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" të dakumemave të tenderit. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm...  
...Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentat e tenderit, procesverbalin e mbajtur nga komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me procedurën e vlerësimit dhe dokumentat e dorëzuara nga ofertuesi "Alked Kopaçi" PF për këtë procedurë në sistemin e prokurimit publik, konstatoi se: Ofertuesi "Alked Kopaçi" PF ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, katalog të lëshuar nga prodhuesi i baterive, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe, me qëllim plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 7, në seksionin 2.3 "Kapaciteti teknik", të Shtojcës 9 të dokumentave të tenderit. Në këtë katalog janë markuar për lehtësi identifikimi bateritë e ofruara, duke përfshirë edhe bateritë NATO, si dhe rezulton se në katalog përfshihen specifikimet teknike të baterive sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të dokumentave të tenderit. Katalogu është shoqëruar me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12).[...]"*

II.4.3. Në datën 09.07.2019, operatori ekonomik “Kappaoil” sh.a. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 19.06.2019, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Alstezo” sh.a. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*“-Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1, gërma a) tek Kriteret e Përgjithshme të Pranimit Kualifikimit të shtojcës 9 të DT, pasi ofertuesi nuk ka në fushën e veprimtarisë së shoqërisë objektin e prokurimit, pra tregëtinë me shumicë/pakicë të baterive.*

*-Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcën 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë katalogë/broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të kërkuara për të gjitha llojet e baterive. Konkretisht nga verifikimi i katalogëve teknike të paraqitura për artikullin “bateri NATO”, me numër rendor 9 në tabelën e përgjithshme (sipas shtojcës 12 të DT-së) nuk është paraqitur katalogë broshurë të baterive, por në vend të saj është ofruar bateri me karakteristika 12 V110Ah.*

*-Gjithashtu, ofertuesi nuk arriti të paraqesë katalogë broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të kërkuara për të gjitha llojet e baterive. Konkretisht nga verifikimi i katalogëve teknike të paraqitura për artikujt “bateri NATO” me numrat rendor 12 dhe 15 referuar tabelës së përgjithshme (sipas shtojcës 12 të DT-së) specifikimet teknike të ofruara nga ofertuesi në raport me specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 10 të DT-së rezultojnë si më poshtë: për artikullin me numër rendor 12, “Bateri 12V 110 Ah”, pesha e baterisë e ofruar sipas katalogut teknik është 28.7 kg nga 32.5 kg të kërkuar në specifikimet teknike (shtojca 10 e DT-së); -, për artikullin me numër rendor 15, “Bateri 12V 125 Ah”, pesha e baterisë e ofruar sipas katalogut teknik është 30.5 kg nga 34 kg të kërkuar në specifikimet teknike (shtojca 10 e DT-së)”*

II.5.1. Në datën 25.06.2019, operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi si dhe duke ngritur pretendime për operatorët e tjerë pjesëmarrës.

II.5.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1154/1 Prot. datë 02.07.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., duke e pranuar ankesën e tij.

II.5.3. Në datën 11.07.2019, operatori ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Ne datën 04.07.2019 jemi njohur me email me shkresën nr. 1154/1 prot., date 02.07.2019 te autoritetit kontraktor (kthimi i pergjigjes se AK eshte jashte afatit 7 ditor te shqyrtimit te ankeses sipas nenit 63 te LPP), ku ankesa jone eshte pranuar.*

*Ne lidhje me kthimin e pergjigjes duam te sqarojme se: Autoriteti kontraktor e ka pranuar ankesen e paraqitur nga ana jone dhe ka cituar se per arsyen e pare te skualifikimit argumentimi i shoqerise Alstezo sha qendron dhe pretendimi pranohet.*

*Ndersa ne lidhje me arsyen e dyte te skualifikimit autoriteti kontraktor na sqaron se kjo arsye skualifikimi eshte dhene vetem nga nje anetar i KVO pra vleresimi ne kete rast thote AK ka qene me*

*shumice votash nga dy anetaret e tjere te KVO te cilet kan votuar pro kualifikimit tone per permbushjen e kriteri. Si rrjedhim AK nuk e ka mare ne shqyrtim kete pretendim tonin . Ne fund te kthimit te pergjigjes AK na ben me dije se kunder ketij vendimi mund te ankohe mi prane KPP ne perputhje me nenin 63 te LPP. Deri sot me date 11.07.2019 nuk kemi mare asnje riklasifikim te ofertave dhe kualifikim te shoqerise sone. AK edhe e pranon ankesen tone per skualifikimin e shoqerise Alstezo sha dhe na drejton te bejme ankim prane KPP, dhe nuk e ka zbatuar vendimin e mare nga KSHA per kualifikimin tone pas pranimit te ankses se bere nga ne. Sa me siper, theksojme se i qendrojme te gjitha pretendimeve te ngritura ne AK dhe te gjithe arsyetimev te dhena te mesiper [..]*”

II.5.4. Në datën 11.07.2019, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Alstezo” sh.a. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*“1- Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues për elementet e vecanta të ofertës ekonomike sipas nenit 56 të LPP-së, ofertë e cila rezultoi anomalisht e ulët, pas rivlerësimit të ofertës në zbatim të vendimit nr.1154 prot., datë 02.07.2019 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës në autoritetin kontraktor. Kërkesa për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët i është dërguar si në rrugë shkresore me shkresën me numër 1243 prot., datë 05.07.2019 dhe njëkohësisht kjo kërkesë i është dërguar ofertuesit edhe në adresën e vet edhe me mesazh në sistemin elektronik në SPE më datë 05.07.2019.”*

II.5.5. Në datën 12.07.2019, operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e operatorëve të tjerë, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

*“[...]Ne daten 09/07/2019 paraqitem nje shkrese prane autoritetit kontraktor duke kerkuar rivleresimin e ofertave dhe kualifikimin e ofertes sone ne baze te vendimit te KSHA qe pranonte ankesen tone dhe na kishte njoftuar me shkresen 1154/1 prot.. date 02.07.2019 e cila ishte kthim pergjigje per ankesen tone protokolluar ne AK ne daten 25.06.2019 me nr. 1154.*

*Ne daten 11.07.2019 paraqitem ankesen tone ne Komisionin e Prokurimit Publik ku ankimiuam skualifikimin e shoqerise sone dhe kerkonim rivleresimin e ofertave sipas pergjigjes se KSHA.*

*Ne daten 11.07.2019 nepermjet sherbimit postar u njohem me shkresat e autoritetit kontraktor shkresa nr. 1154/1 prot date 05.07.2019 Vendimi i KSHA per pergjigjen e ankses tone protokolluar ne autoritetin kontraktor me nr. 1154 prot date 25.06.2019, sipas se ciles pretendimet e ngritura nga shoqeria jone qendrojne dhe ankesa pranohet. kjo pergjigje ka ardhur njehere me email me shkresen me te njejtin numer protokolli 1154/1 prot , por me date tjeter 02.07.2019. shkresa nr. 1243 prot date 05.07.2019 me objekt “Kerkese per informacion mbi oferten anomalisht te ulet. Shkresa e mesiperme referuar shkresave te sherbimit postar qe do ti gjeni bashkelidhur kane ardhur ne daten 11.07.2019. Po ne daten 11.07.2019 njihemi ne SPE se oferta jone eshte skualifikuar me argumentin se:*

*Oferta juaj OFFER-151718052019 per tenderin REF-21332-05-09-2019 "Loti II "Blerje bateri për automjete” [MAIN CALL: REF-21327-05-09-2019 ""Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbime profilaktike për Komandën Mbështetëse ""] eshte refuzuar.*

**REASONS :**

*Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues, për elementet e vecanta të ofertës ekonomike, sipas nenit 56 të LPP-së, ofertë e cila rezultoi anomalisht e ulët, pas rivlerësimit të ofertës, në zbatim të vendimit nr.1154 prot., datë 02.07.2019 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës,*

në autoritetin kontraktor. Kërkesa për informacion, mbi ofertën anomalisht të ulët, ju është dërguar si në rrugë shkresore, me shkrsën me numër 1243 prot, datë 05.07.2019 dhe njëkohësisht kjo kërkesë i është dërguar ofertuesit në adresën e vet edhe me mesazh, në sistemin elektronik në SPE më datë 05.07.2019.

Kundershtojme kete arsye skualifikimi si te padrejte dhe jo te bazuar ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe eshte nje procedure e zhvilluar ne kundershtim me nenin 56 te LPP. Ankimin tone e bazojme ne legjislacionin ne fuqi pasi eshte nje arsye skualifikimi qe nuk qendron.

Fillimisht duam te permendim parregullsitet e autoritetit kontrator ne kete procedure prokurimi. AK me veprimet e tij deshmon hapur qellimin per te skualifuar oferten e shoqerise Alstezo sha me cdo kusht, duke shkeluar cdo parim e rregull te percaktuar ne ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Fillimisht skualifikon shoqerine tone per shkaqe te paligjshme, e vertetuar kjo me pranimin e ankeses sone te dates 25.06.2019 te depozituar prane ABP, pranim ky i bere me shkresen Vendim nr. 1154/1 prot. Date 02.07.2019. Agjencia e Blerjeve te Perqendruara deri ne daten 11.07.2019 pra 9 dite nga data 02.07.2019 qe ka kthyer pergjigjen per pranim ankese, nuk jep asnje pergjigje ne lidhje me veprimet e saj per rivlersimin e ofertave edhe pse ne daten 09/07/2019 ne kemi paraqitur kerkese prane AK per kualifikimin e shoqerise sone ne baze te vendimit te saj date 02.07.2019 , nr. 1154/1 prot. Ne menyre arbitrare, autoriteti kontraktor ne tejkalim te te gjitha afateve, skualifikon shoqerine Alstezo sha me argumentin se nuk kemi paraqitur argumentat per oferten anomalisht te ulet, kur ne fakt prej saj nuk eshte bere asnje njoftim.

Ne nenin 56 te LPP percaktohet : "1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: 3.) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të infomacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Ne VKM 914 te dates 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", neni 66, pika 5, citohet: 1. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së percaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja, e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave tëvlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Nuk e kuptojme kete menyre zhvillimi procedure prokurimi nga ana e autoritetit kontrator dhe nxitimin per te skualifikuar shoqerine Alstezo sha duke shkelur te gjitha parimet e LPP dhe duke



mos respektuar asnje lloj procedure. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka ardh asnje kerkese me shkrim deri me daten 11.07.2019 fakt i provuar me dokumentin zyrtar, dhe ne nuk jemi vene ne dijeni per kerkesen e AK apo qe oferta jone ka dale anomalisht e ulet. Ne kushtet kur nuk kemi nje njoftim te tille AK nuk mund te beje nje skualifikim pa e lene shoqerine tone te paraqese dokumentacionin dhe argumentet per oferten e tij. Nuk e kuptojme se ku e ka derguar AK shkresen e cituar ne arsyen e skualifikimit, apo ka ndonje konfirmim nese ne e kemi marre njoftimin per te paraqitur argumentata tona sepse ne nuk kemi asnje njoftim. I vetmi njoftim qe ne kemi eshte shkresa nr. 1154/1 prot date 02.07.2019 e ardhur me email ne date 4.07.2019 ne adresen tone. Autoriteti kontraktor ne daten 02.07.2019 me shkresen 1154/1 prot thjesht ka thene qe ankesa pranohet dhe nuk ka bere asnje sqarim tjeter me tej, gje qe e kishte te gjitha mundesine ne zbatim te ligjit dhe rregullave te prokurimit, por ne mnd te kesaj shkrese citon qe mund te ankohe mi prane KPP sipas nenit 63 te Lpp. Nuk e kuptojme si gjykon autoriteti kontraktor kur thote se jemi skualifikuar se nuk arrihem te paraqesim argumentimet per oferten anomalisht te ulet ne kushtet kur edhe pse shkresa e saj Kerkese per informacion mbi oferten anomalisht te ulet mban daten 05.07.2019 me nr. 1243 prot por qe referuar gjurmimit postar te dokumentit me kod bar RR602413292AA nga po vete autoriteti juaj kontraktor eshte depozituar ne poste ne daten 09.07.2019 pra pas 4 ditesh nga protokollimi i saj? Data 09.07.2019 vertetohet edhe nga fakti i vules qe eshte mbi zarf. S' 5. Autoriteti kontraktor nuk mund te protokolloje nje shkrese ne daten 05.07.2019 dhe te depozitohet per ne poste ne daten 09.07.2019 per me shume kur kemi te bejme me procedura prokurimi ku afatet jane shume te rendesishme. Gjithashtu shkeljet e autoritetit kontraktor vazhdojne edhe me shkresen tjeter qe eshte nisur po ne daten 9.07.2019 dhe ka mberritur prane shoqerise sone ne daten 11.07.2019. Autoriteti kontraktor duke pershpejtuar hapat per te skualifikuar me cdo arsye shoqerine Alstezo sha edhe pse oferta me cmim me te mire nga ana ekonomike, ka pershpejtuar edhe duke sjelle serish shkresen me objekt Vendim te KSHA per shqyrtimin e ankeses se paraqitur nga ana jone ne daten 25.06.2019 prane AK per skualifikimin e pare por me disa gabime brenda saj. Ngreme dyshimet tona te cilat pasi shkresa Vendim per shqyrtimin e ankeses ka te njejten permbajtje si ajo e ardhur me poste ne daten 11.07.2019 edhe ajo e ardhur me email ne daten 04.07.2019, por kane disa gabime pasi kane te njejten numer protokolli 1154/1 por data te ndryshme njera date 02.07.2019 dhe tjetra 05.07.2019. Nuk e kuptojme si mundet nje autoritet kontraktor te protokolloje nje shkrese me te njejten permbajtje me te njejtin numer protokolli por me dy data te ndryshme? Te gjitha keto veprime te autoritetit kontraktor lene vend per dyshime te arsyeshme per veprimet te qellimshme te AK per skualifikimin e shoqerise Alstezo me cdo mjet madje edhe me dokumenta te dyshimta e te protokolluara me data te cuditshme. Dyshimet per veprimet e autoritetit kontraktor shtohen edhe me faktin tjeter qe shkresat jane protokolluar qe ne daten 05.07.2019 dhe nuk e dime per cfare arsyesh nuk nisen me poste ne destinacionin e shoqerise te ciles i drejtohen por mbahen me qellim ne zyrtar e AK dhe dergohen per postim 4 dite me pas. Pa sens edhe arsyeja e skualifikimit te AK pasi harron se shkresa me objekt Kerkese per informacion per oferten anomalisht te ulet e ka protokolluar ne daten 05.07.2019, ne brendi te saj citon se brenda 3 diteve pune duhet te paraqiten argumentat me shkrim nderkohe qe shkresa rri ne zyrtar e institucionit dhe dergohet per postim ne daten 09.07.2019. Atehere natyrshem lind pyetja: si e ka llogaritur afatin 3 dite pune AK kur e ka nisur shkresen ne poste ne daten 09.07.2019 dhe nuk ka asnje dijeni fakt apo prove se ne cilen date eshte njohur Operatori ekonomik me kete njoftim???

Sqarojme se arsyeja e dhene ne sistem qe ne jemi skualifikuar se nuk kemi paraqitur ne AK pergjigje per kerkesen e ABP per argumentimin e ofertes anomalisht te ulet eshte e pabazuar dhe nuk qendron. Ne nuk kemi asnje dijeni per kete fakt pasi njoftimi dhe komunikimi i vetem qe kemi

nga autoriteti kontrktor eshte njoftimi i bere ne shkresen 1243 prot date 05.07.2019 mare dijani nga ne ne daten 11.07.2019. Autoriteti kontrktor nuk mund te vijojte me hapat e metejsjme te procedures pa mbaruar procesin per verifikimin e elementeve te ofertes anomalisht te ulet nese ka nje oferte te tille. AK qellimisht ka bere lojra e zvarritje me datat, me protokollin, me postimin, me kthimin e pergjigjes vetem per te arritur qellimin per skualifikimin e shoqerise sone. Qe ne daten 02.07.2019 me shkresen 1154/1 prot AK mund te sqaronte qe pranonte ankesen dhe oferta jone kishte dale anomalisht e ulet dhe te kerkonte sqarimet perkatese. AK nuk mund te skualifikoje nje shoqeri apriori pa marre dijani nese shoqeria eshte njoftuar apo jo ne lidhje me kerkesen e tij. Sqarojme dhe njehere qe ne adrese te shoqerise nuk eshte paraqitur asnje kerkese apo shkrese nga autoriteti kontrktor per kete procedure prokurimi per argumentim oferte, pasi nga ana jone do te ishte paraqitur nje argument i tille perderisa kemi marre pjese ne procedure do te thote qe jemi te interesuar per te, per me teper me nje oferte te mire ekonomike. Duke ju referuar thelbit te ceshtjes pra skualifikimit te ofertes sone qe ajo ka dale anomalisht e ulet serish edhe per keto AK nuk ka dhene detaje se ciles element apo produkte te saj konsideron ajo anomalisht te ulet, me qellim edhe dhenien e nje argumentimi te sakte nga ana jone. Nga ana tjeter konstatojme se edhe oferta e operatorit ekonomik te kualifikuar eshte anomalisht e ulet dhe kemi dyshimet tona se kjo kompani nuk arrin te argumentojte ate sipas te gjitha percaktimeve ligjore ne fuqi si edhe kerkojme hetim te menyres dhe procedures se argumentimit te ofertes se ketij operateme nisur kjo nga menyra jo korrekte dhe jo ligjore qe ka vepruar AK me shoqerine tone.

Kerkojme te ballafaqohemi duke bere hetim shkreses se AK qe ka nisur ne drejtim te shoqerise sone me qellim qe ne te paraqesim faktet dhe argumentat per oferten anomalisht te ulet, se kur eshte nisur se kur eshte nisur dhe derguar me qellim trajtimin e barabarte te operatoreve ekonomike dhe mosdiskriminimin e tyre dhe perjashtimin nga gara pa i lene te paraqesin te gjitha argumentat e dokumentacionet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ne nuk kemi pasur asnje dijani lidhur me kete kerkese dhe na eshte mohuar e drejta per te paraqitur dokumentacionin perkates justifikues, duke bere qe AK te nxitonte per te kaluar tek operatori ekonomik i renditur i dyti duke shkaktuar edhe nje dem ekonomik duke mos respektuar percaktimet ligjore ne fuqi. Autoriteti kontrktor nuk jep asnje fakt dhe prove se kur e ka nisur shkresen apo ku e ka derguar ate duke na krijuar bindjen se eshte vete autoriteti kontrktor pergjegjes per krijimin e situatave te tilla, pasi eshte pergjegjesi e tij per te njoftuar dhe çuar ne kohe te gjitha shkresat apo kerkesat per sqarim apo per ofertat anomalisht te ulet, si edhe per nje proces te rregullt prokurimi, transparent, jo diskriminues, duhet te sigurohet per njoftimin apo marrjen dijani nga ana e operatoreve ekonomike me qellim mospengimin e procedures dhe zvarritjen e saj. Persa kohe qe ne nuk kemi marre asnje njoftim me sherbim postar deri ne daten 11.07.2019 date ne te cilen edhe AK na skualifikon, nuk mundet te na mohohet nje e drejte ligjore per te paraqitur dokumentat tona per justifikimin dhe argumentimin e ofertes anomalisht te ulet, pasi keshtu autoriteti kontrktor cenon edhe parimin e sigurise juridike te nje procesi te rregullt ligjor. Ne ne asnje moment nuk kemi pasur dijani per nje kerkese te tille ndaj kerkojme te na jepet mundesia duke zhvilluar keshtu edhe nje proces te rregullt ligjor. Autoriteti kontrktor ashtu sic percaktohet edhe ne legjislacionin per prokurimin publik, perpara se te mbylle klasifikimin perfundimtar duhet te beje te gjitha komunikimet dhe te dergoje kerkesat perkatese ne drejtim te operatoreve ekonomike ofertat ekonomike te te cileve dalin anomalisht te uleta, duke ju dhene mundesi operatoreve te japin argumentat e tyre, e cila nuk ka ndodhur ne kete rast, duke skualifikuar pa te drejte shoqerine tone. Autoriteti kontrktor duhet te kualifikoje shoqerine tone se eshte edhe oferta me e ulet ne kete procedure prokurimi dhe nuk mund te skualifikoje pa shkaqe dhe arsye bindese. Autoriteti kontrktor me cdo menyre dhe cdo mjet duhet te beje te mundur dhe te lejojte operatoret ekonomike te paraqesin dokumentacionin e tyre ne rastet

kur oferta ekonomike del anomalisht e ulet. Autoriteti kontraktor edhe ne shkrusen 1243 prot date 05.07.2019 ne tejkalim te kompetencave te saj dhe ne shkelje te ligjit citon qe kerkojme te paraqisni me shkrim/ne rruge elektronike dhe brenda 3 diteve pune shpjegimet per oferten anomalisht te ulet, duke shkelur nenin 56 te lpp i cili percakton ne menyre taksative qe ne lidhje me oferten anomalisht te ulet te gjitha komunikimet jane vetem me shkrim. Ne anen tjetër ne baze te percaktimeve ligjore ne fuqi shoqeria jone do te njoftoje brenda afateve ne lidhje me argumentimet e ofertes anomalisht te ulet sipas shkreses 1243 prot date 05.07.2019, ardhur me poste dt.11.07.2019, duke paraqitur argumentimet tona per oferten anomalisht te ulet. Nderkohe qe pamvaresisht shumatores se çmimit/Njesi, oferta jones perket Vleres totale per sasine e pritshme te baterive te kerkuara rezulton qe nuk eshte anomalisht e ulet. Nga ana e AK nuk eshte kerkuar asnje argument apo cilesim konkret lidhur me cmimet e artikujve qe perbejne oferten anomalisht te ulet. Sikurse AK eshte ne dijeni, kapacitetet tona lidhur me oferten e paraqitur jane me se te argumentuara nisur nga fakti qe ne jemi Importues dhe tregetes te baterive te te gjitha BRAND-ve prodhim Lubatex, gje te cilen e kemi argumentuar edhe me dokumentate te paraqitura ne SPE se bashku me oferten si dhe dokumentat e çdoganimit te mallit shoqeruar me faturat e bleljes se baterive direkt ne kete Kompani, te cilat I kemi paraqitur ne ankimimin tone te dt.25/06/2019 (me nr. Rregjistrin te AK Nr.11)

Nderkohe qe Shoqeria ALSTEZO sha ka nje partneritet te ngushte dhe bashkepunim me kompani brenda dhe jashte vendit, te cilat jane importues direkt te baterive qe kerkohen nga AK. Duke qene te tille, pra nisur nga ky fakt, theksojme edhe njehere se jane te gjitha mundesite e argumentimit nga ana jone te ofertes qe kemi paraqitur per konkurim ne kete procedure prokurimi, por qe kjo mundesi na u privua me qellim nga AK per te arritur ne skualifikim te qellimshem te ofertes tone si dhe duke bere keshtu nje diskriminim per ne si OE pjesemarrës ne kete tender. Shoqeria jone ne lidhje me veprimet e autoritetit kontraktor do te njoftoje te gjitha hallkat dhe organet perkatese per verifikimin e dokumentacionit te mbajtur prej saj, pasi ngjall dyshime per veprime te kundraligjshme si me datat e shkresave, protokollimet e tyre si edhe dergimet e tyre ne organet postare duke bere shkak nje proces jo te rregullt dhe skualifikim pa te drejte te operatoreve ekonomike[...]"

II.5.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1288/1 Prot. datë 15.07.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes "Alstezo" sh.a., duke mos e pranuar ankesën e tij, me arsyetimin si më poshtë vijon:

"[...] Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me marrjen e vendimit nr. 1154/1 datë 02.07.2019 të shoqërisë "Alstezo" sha, ka zbatuar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në sistemin e prokurimit elektronik, në datë 05.07.2019 duke rivlerësuar procedurën e prokurimit me qëllim kualifikimin operatorit ekonomik "Alstezo" sha. Nga gjenerimi i renditjes përfundimtare, me ofertat e vlefshme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka konstatuar që oferta e kualifikuar, rezulton ofertë anomalisht e ulët. Për sa më lart. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në zbatim të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik. neni 56 pika 1), "Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdoje me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të pararqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të vecanta të ofertës" i ka kërkuar ofertuesit, sqarime me shkresën nr. 1243 prot, datë 05.07.2019 me lëndë: "Kërkes për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët ", ku në përmbajtje të saj përcaktohet se: "... përpara se të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave, ju kërkojmë të paraqisni me shkrim/në rrugë elektronike dhe brenda 3 (tre) ditëve pune shpjegime për element të veçantë të ofertës tuaj / Për

shpejtësi veprimesh, kërkesa ju dërgohet edhe në formë elektronike në [ëëë. app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al)“ Shoqëria “Alstezo” sha, nuk ka kthyer përgjigje as në rrugë elektronike, por as edhe në formë shkresore, “Sqarime” për ofertën anomalisht të ulët. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, më datë 05.07.2019 i ka dërguar ofertuesit “Alstezo” sha, me anë të opsionit “kërkes e re”, sqarime për ofertën anomalisht të ulët, në sistemin e prokurimit elektronik. Po në datë 05.07.2019, është dërguar shkresa në rrugë shkresore me anë të postës, me të njëjtën përmbajtje “Kërkes për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, më datë 11.07.2019, ka përfunduar vlerësimin në sistemin elektronik. dhe ka njoftuar personin përgjegjës të njësisë së prokurimit, të bëjë mbylljen e fazës jeshile “vlerësimi i ofertave” në dosjen e tenderit, për këtë procedurë prokurimi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka pritur plotë 6 (gjashtë) ditë kalendarike, dhe 3 (tre) ditë pune, ofertuesin “Alstezo” sha, për të paraqitur informacionin për ofertën anomalisht të ulët. Ofertuesi “Alstezo” sha, është skualifikuar nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave, me arsyetimin se, nuk ka paraqitur informacionin e kërkuar, brënda afateve kohore të përcaktuara në kërkesën e përcjellë, në sistemin e prokurimit elektronik [...]”

II.5.7. Në datën 24.07.2019, operatori ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Në datat 26.07.2019 dhe 02.08.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresave nr.1302/1prot. datë 23.07.2019, nr.1311/1prot., datë 23.07.2019 dhe nr.1346/1prot., datë 01.08.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, informacionit të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të ankimuesve,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kappaoil” sh.a., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: [...] - Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcën 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë katalogë/ broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Të gjithë dokumentat e hedhura, si pjesë të ofertës dhe të emërtuara “HEAVY DUTTY SHQIP”, “Nato bateri shqip 2019”, “Passenger cars shqip 2019 marked” nuk janë të lëshura nga kompanitë prodhuese, të deklaruara ne tabelën e përgjithshme të ofertës teknike. Po ashtu, ky dokumentacion nuk është i përkthyer nga përkthyes zyrtarë dhe nuk është i vërtetuar me origjinalin nga noteri publik.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9, (Loti II) pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/ broshurë të baterive**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet te

markohen (per lehtësi identifikimi) artikujt bateri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikullit (gomës)</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Emërtimi kompanisë prodhuese</b>	<b>Emërtimi i katalogut</b>	<b>Numri i faqes në katalog</b>	<b>Part-Number i prodhuesit</b>	<b>Standarti i Cilësisë</b>
------------	--------------------------------------	---------------	--------------	-------------------------------------	-----------------------------	---------------------------------	---------------------------------	-----------------------------

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”* “

III.1.3. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kappaoil” sh.p.k. në SPE, rezulton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit, ka paraqitur ofertën teknike, në të cilën konstatohet se produktet e ofruara janë të kompanisë prodhuese “Yigit Aku Malz.Nak.San.Ve Tic.A.S”, e cila ka autorizuar ankimuesin për të ofertuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu, konstatohet se ankimuesi ka paraqitur skeda teknike të baterive në gjuhën shqipe. Nga verifikimi i skedave teknike, të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, rezultoi se skedat teknike “Bateri për Automjete Europiane”, “Bateri për Automjete Aziatike” dhe “Bateri për Mjete të Rënda”, nuk kanë asnjë markë, apo cdo shenjë tjetër identifikuese se, këto skeda teknike janë të produkteve të ofruara në ofertën teknike dhe të kompanisë prodhuese “Yigit Aku Malz.Nak.San.Ve Tic.A.S”, e cila ka autorizuar ankimuesin për të ofertuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Komisioni gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga ankimiuesi në përmbushje të kriterit të mësipërm, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe është e pamundur të vërtetohet lidhja ndërmjet produktit të ofruar në ofertë, për të cilin është paraqitur edhe dokumentacioni përkatës, me skedat teknike të ngrkuara në SPE, për shkak të mungesës të cdo shenje identifikuese të prodhuesit. Komisioni thekson se kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve

dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.5. Në rast se operatori ekonomik ankimues “Kappaoil” sh.a. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kappaoil” sh.a. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Alked Kopaci” p.f., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjisllacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se,

pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a, mbi vendimin e datës 19.06.2019 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor me anë të shkresës Nr. 1154/1 Prot. datë 02.07.2019, ka kthyer përgjigje, duke informuar se pretendimi i operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, është shqyrtuar dhe është marrë parasysh, e si rrjedhim ankesa e tij është pranuar.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ankesa e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a lidhur me vendimin e datës 19.06.2019 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është pranuar nga autoriteti kontraktor, ndaj nuk do të merret në shqyrtim në themel pasi nuk eksiston më si objekt ankimi.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *[...] -Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues për elementet e veçanta të ofertës ekonomike sipas nenit 56 të LPP-së, ofertë e cila rezultoi anomalisht e ulët, pas rivlerësimit të ofertës në zbatim të vendimit nr.1154 prot., datë 02.07.2019 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës në autoritetin kontraktor. Kërkesa për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët i është dërguar si në rrugë shkresore me shkresën me numër 1243 prot., datë 05.07.2019 dhe njëkohësisht kjo kërkesë i është dërguar ofertuesit edhe në adresën e vet edhe me mesazh në sistemin elektronik në SPE më datë 05.07.2019.[...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se *[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...]*”.

III.4.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se *“Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas*

*formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]*”

III.4.3. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjen teknike zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por



gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.4.4. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, kjo ofertë në bazuar në nenin 66 pika 5 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët dhe autoriteti kontraktor në zbatim të parashikimeve të *lex specialis*, neni 56 dhe nenit 66 të VKM 914/2014 i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik ankimues mbi ofertën e dorëzuar në këtë procedurë prokurimi.

III.4.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si dhe provave shkresore të administruara, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar informacion mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, me anë të shkresës nr. 1243 prot., datë 05.07.2019, shkresë e cila, referuar gjurmimit të objektit postar me kod RR602413292AA, i është dorëzuar operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., në datën 11.07.2019. Gjithashtu, Komisioni konstaton se edhe njoftimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e ofertës së tij, me arsyen “*Ofertuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues për elementet e vecanta të ofertës ekonomike sipas nenit 56 të LPP-së, ofertë e cila rezultoi anomalisht e ulët, pas rivlerësimit të ofertës në zbatim të vendimit nr.1154 prot., datë 02.07.2019 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës në autoritetin kontraktor. Kërkesa për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët i është dërguar si në rrugë shkresore me shkresën me numër 1243 prot., datë 05.07.2019 dhe njëkohësisht kjo kërkesë i është dërguar ofertuesit edhe në adresën e vet edhe me mesazh në sistemin elektronik në SPE më datë 05.07.2019*”, është në datën 11.07.2019. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar përcaktimet e parashikuara në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me procedurën që duhet ndjekur nga autoritetet kontraktore në rastet e konstatimit të një apo më shumë ofertave anomalisht të ulta, pasi nuk ka respektuar afatin e parashikuar në përcaktimin ligjor të sipërcituar, duke e skualifikuar operatorin ekonomik ankimues në të njëjtën ditë kur ky u fundit është njohur me shkresën nr. 1243 prot., datë 05.07.2019. Komisioni thekson se, përlllogaritja e afatit prej 3 ditësh pune, nis nga data e marrjes dijeni mbi shkresën me anë të së cilës kërkohet informacioni dhe jo nga data e regjistrimit të shkresës në sekretarinë/protokollin e autoritetit kontraktor. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a., e cila rezulton anomalisht e ulët, autoriteti kontraktor duhet përsërisë procedurën e parashikuar nga neni 56 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me qëllim që ankimuesit t’i jepet e drejta e paraqitjes së provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alked Kopaci” p.f., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike. Sa më sipër, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

## **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kappaoil” sh.a. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt, *Loti II "Blerje bateri për automjete"*, me nr. *REF-21332-05-09-2019*, me fond limit për njësi 355,370.83 lekë (pa TVSH) dhe vlerë të pritshme të kontratave 22,543,765 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a., lidhur vendimin e KVO-së të datës 11.07.2019, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. lidhur me vendimin e KVO-së të datës 19.06.2019, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të zbatojë procedurën e parashikuar në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. për ankesën nr.1245 prot., datë 11.07.2019 dhe ankesën nr. 1296 prot., datë 24.07.2019.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1231 protokoli Datë 09.07.2019;**

**Nr. 1245 protokoli Datë 11.07.2019;**

**Nr. 1296 protokoli Datë 24.07.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**